


BIBLIOTEKA
SHTETIT

8JH-1
MI7



Feride Mahmudaj

ENDRRAT DHE FISHEKZARET
lirika

801885-1



FERIDE MAHMUDAJ ka lindur në vitin 1951, në qytetin e Shkodrës. Një pjesë të fëmijërisë e kaloi në Shkodër, Burrel dhe Tiranë. Në vitin 1968 mbaroi shkollën e mesme të përgjithshme «Dervish Hekali» në Ballsh.

Kreu studimet e larta në USHT dhe në vitin 1972 u diplomua në degën gjuhëletërsi. Tani punon mësuese letërsie në shkollën e mesme të përgjithshme «Asim Vokshi» të qytetit Bajram Curri.

Ky është libri i saj i parë.

814-1
1412

FERIDE MAHMUDAJ

ËNDRRAT DHE FISHEKZARËT

Lirika



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

N E S È R

Nesër do të shkoj në Ballsh me tren,
qytetin do ta gjej zgjuar dhe në mesnatë;
nëpër këngë grunoresh dhe ullishtash si refren
sirenën e gjëzimit treni do të përhapë.

Oxhaqe, nulla nafte po ngjiten në ajri,
kraharori i qytetit gumëzhitin si në festë...
Ja, saldatorja e dalluar, e bukura Liri
ngrihet simbol mbi nulla, mbi vjershë.

Këto çaste dëgjoj traktrokun e trenit
dhe zhurmën e zilkave që tretet diku larg,
me imazhin tragjik të rrugëve të kurbetit
ku mallakastriotët iknin pas mushkave varg.

Nesër do të shkoj me tren në Ballsh,
qytetin tim prej hekuri do ta përshëndes;
nëpër zëra të fortë, nëpër takime kallosh
sinjalin e lokomotivës ndjejë këtë mëngjes!

FJALËT E MIA

Unë dua që fjalët e mia
të jenë trëndafilë pér të rënët;
pér armiqjtë të jenë si krisma,
si gurë të ftohtë e të rëndë.

Unë dua që fjalët e miá
të jenë si lëndina bleroshë,
ku rriten mendime të çiltëra,
ku çelin buzëqeshje rinore.

Unë dua që fjalët e mia
të jenë si qelli i majit,
ku vezullojnë mijëra yje
si yll' i bustinës së babait...

Unë dua që fjalët e mia
të jenë si det i paanë,

ku kaltëron përjetë dashuria
dhe ngre revolucioni dallgë.

Unë dua që fjalët e mia
të jenë si bukë e bardhë,
si furrnalta të nxerrin shkëndija,
të jene të sigurta si armë!

PËRPLASEN EPOKAT

Përplasen epokat
e në trup të botës,
si lapidar madhështor
është ngulur heroizmi i popujve.

Përplasen epokat;
mbi kulmet e tyre
si këngë pa fund,
ushtojnë ritmet e revolucioneve.

P O R T R E T

Veteran flokëtinjur, atdheu im,
i dashuri atdhe, me copëra predhash në mish,
madhështor kryelartë
mes stuhish.

Ushtar sypafjetur, atdheu im.
i dashuri atdhe, me trup të stralltë,
nga veriu kreshtadëborë
te jugu i kaltër.

Djalosh shpatullgjerë, atdheu im,
i dashuri atdhe, me zemër komuniste,
me damarët plot ritme kantieresh,
me bebëzat plot yje.

M O N T A T O R È T

Anekënd atdheut
montatorët shtegtojnë,
u lidhin kërthizat uzinave,
kaskadat në dritë i shndërrojnë.

I njojin ata lumenjtë malorë,
edhe zogjtë mbi tela,
nga Elbasani i hekurt
gjer te Ballshi e Fierza.

Kantier më kantier
rendin majë makinave,
fytyrat e tyre të qeshura
na shfaqen inaugurimeve...

Ç A S T

Përse ky çast i trishtuar
zemrën në grusht ma shtrëngon?
Në heshtje qëndroj e menduar,
gjaku ndër deje më vlon...

Përsëri e shpalos këtë letër,
e shikoj me dhembje, mëri.
Një kohë e perënduar, e vjetër
më flet për zakon, mblesëri!

E di se ky çast do të ikë
si pluhur që tretet në erë,
zëri im në ajër do të ngrihet
si gurgullimë përroi në pranverë...

1969

M E N D O J

Vitet ikin...
Mendoj pér ty, toka ime,
që pllajat dhe brigjet e buta
t'i kafshuan gërryerjet
dhe luftërat...

Mendoj...

Dua të jem pér ty pemë e blertë,
e mbërthyer fort pas gurëve e plisave,
toka ime solide e shtrenjtë,
pérballë stuhive!

S'TU LODHËN KËMBËT, BABA

Babait të dashur

Si s't'u lodhën këmbët, i dashur baba?
Nga Mallakastra gjer në Sanxhak,
plumbi i huaj në kapotë të ra,
fshika e plumbit në ballë të la vragë.

Por ti asnijëherë, baba, nuk u ndale,
kapërceve male me gremina, dëborë,
të ktheheshe prapë në gji të tokës sate,
ku ullinjtë e djegur ta bënin me dorë.

E di, shpesh ndjen dhembje në zemër, baba,
kur të kujtohen vitet e krismave,
kur shokët trima të vriteshin në krah
e këmbët e gjakosura të ngjiteshin pas opingave.

Të kujtohen plagët e hapura të shokëve,
rrethimet, kundërsulmet, këngët...
po ti ece midis predhave e bombave
të m'i madhoje sa hapësira ëndrrat!

Të kujtohen netët e ngrira në veri,
përlleshjet me banditë e diversantë,
por ti ece, baba, përsëri,
shaminë e aksionit të ma lidhje në qafë.

Ece, që një agimi të bukur
të më nisje mësuese për në bjeshkë,
që me dekoratat e luftës e këmbët e sëmura
të hyje e të ecje përjetë nëpër vjershë...

Si s't'u lodhën këmbët, i miri baba?
Nga Mallakastra gjer në Sanxhak,
plumbi i huaj mbi kapotë të ra,
fshika e plumbit mbi ballë të la vragë!

PRANVERË NË EKRAN

Era malore me gishta të hollë
ua shpupurit drurëve flokët e verdhë,
dhe mbrëmja që bie erë mollë,
mbi supe malësorësh yje hedh.

Në fushën e qetë pulson projektori,
lëviznin në ekran njerëz, peizazhe,
hapësira të mbushura me diell qershori,
me buzëqeshje si dëbora në male.

Mes pranverës së gëzimit të njerëzve,
madhështor, buzagaz flet Enveri...
dhe u shtohen lule të reja bjeshkëve,
më të lartë e ndjen veten Shkëzeni.

Përballë maleve plot krisma lirie,
Enveri qëndron me grushtin lart...
Në ritme vallesh, në tela çiftelie,
rrjedh Valbona e qetë, e kristaltë.

Pulson projektori... Pamjet rrëshqasin
dhe pranvera buis në ekran,
malësorëve u vjen të duartrokasin
sikur Enveri të ndodhej aty pranë!

Enveri eshte mes tyre gjithmonë
si një pranverë e madhe pa cak,
dhe ku mbrëmjet bien erë mollë,
dhe kur vjeshta pyjet i përflak...

sigurishtë e tashmë që i kemi
nëpër lloqarët e vjetra, që i kemi
një përgjithësi që i kemi
të dhë gjithë që i kemi.

N E V E R I

E dua gjithshka të bukur në jetë,
një rëzit tanë të mirë që dërsijnë...
Por për indiferentët ndjej urejtje,
janë si hije që kotojnë e vijnë.

Syhapur ecin, por veç veten shohin,
lëvizin në jetë si ushtarë plumbi,
mikrobeta e tyre, tunel pa portal,
shpirti i tyre si peshk akuariumi.

Bota e madhe për ta është e largët,
është e huaj, absurde, e frikshme...
Si molusku që fshihet në guaskë,
ata struken ndër mendime meskine.

Mbi konturet e djersës rritet e ardhmja,
në damarët e jetës gjaku ynë vlon,
indiferentët ngjajnë si fosile të lashta,
ata janë dezertorë të kohës sonë!


P I S H T A R I

1

Si pishtar, ndriçove, Parti,
këtë tokë të lashtë...
O, sa etje kish toka ime për dritë
dhe sa pak i dhanë kohërat,
sa pak!

2

Donte dritë Shqipëria,
me krahë fajkoi të çante
hapësirat e jetës,
të mos ishte para saj horizonti
i turbullt
si në sytë e të verbit.



Midis errësirës së kobshme
 si diell u ndez
 ky pishtar që përflaku zemrat.
 Toka ime u drodh nga gëzimi,
 u drodh qielли shqiptar
 nga të shiënati...

Mes kohërave ecën Shqipëria,
 përleshet me shqotat,
 flakët e pishtarit më lart ngjiten,
 pushtojnë horizontet!

1969

S O N T E

Bjeshkët kanë hedhur vello të bardhë,
më të bucura se kurrë po më ëduken,
nuse me temina, nuse duke qarë,
mbi supe lule molle u shkundën...

Mes valles fantastike të dëborës
eci dhe ndjej pranë ngrohtësinë tënde,
i dashur, si vajzë e vogël me fjongo
rrugëve dua të endem këtë mbrëmje.

Të përzihen sonte me flokët e mi,
këta flokë të bardhë e të kristaltë,
ndërsa dritat vezullojnë si inxhi,
mbi bjeshkët e bardha si përrallë!

PENSIONISTËT NË FIERZË

Në Fierzë,
atje ku lind diga,
pensionistët kanë ardhur,
bëjnë kuvend me ta ujërat e Drinit,
me gjuhë të shkumëzuar valësh...

Ata janë
pesëdhjetë flokëthinjur,
banorë të qytetit të bjeshkëve;
në rrudhat e ballit, që zgjaten si shina,
kanë mbresat e trasesë, të tuneleve.

Dikur
këto gërxhe e gryka,
nga krismat e tyre kanë gjëmuar,
që karafilë gëzimi të hedhë liria,
në sytë e vogëlushëve syshkruar!

Në brigjet

e ngarkuara me beton e metal,
djersën e tyre të ngrohtë kanë sjellë,
që të rritet më shpejt qyteza e bardhë,
që mbi shpatullat e maleve
qindra diej të ketë!

MIGJENI DHE DRITA

Si ike, ashtu, Migjen?!

U këpüte
si yll i flakëruar
në një natë dimri
me qiell të turbullt...

A erdhi ndonjë rreze atë natë,
në tokën e ftohtë
të të përcillte,
të të sillte një grusht rreze,
një grusht drite?..

Ti Migjen doje dritë,
dhe në varr për të ke thirrur...
Ne e kemi ndjerë:
«Pak dritë!
Pak dritë!»

Klithmë dhembjeje,
klithmë lufte
zëri yt...

Migjen!

Që mbi ditët dhe netët tona,
mbi vargjet e tua,
mbi varrin tënd,
të breronte drita,
duhej të agonte dielli yt alegorik,
të lindte Partia.

1970

U S H T A R A K E

Sot ke veshur uniformën e blertë,
në taktikë i djersitur vrapon,
kur lëviz vetëtimë te transhetë
dhe për mua patjetër mendon...

I dashuri im, unë mirë e di,
«armikun» në gjoks do ta godasësh,
të shoh në pozicion, nën shi,
dhe era më sjell krisma armësh...

Në armaturë ti pushkën do të lësh,
te nxënësit e tu do të vish nesër;
unë kapotën ngjyrë gri do të vesh,
mes alarmit do të rend sypatrembur!

ENDERRAT DHE FISHEKZARËT

Hedh sytë lart,
fishekzarët e ndritshëm vështroj,
disa shuhën,
sërisht ndizen të tjerë...

Por ëndrrat e mia,
në qielin e lirë shqiptar
u ndezshin,
flakërofshin përherë!

1969

V E N D L I N D J E S

E ashpér
Mallakastra trime,
më shumë lapidarë se gurë,
me kaq metal,
me një peshë të tillë lumturie
nuk ka mbajtur kurrë!

Këtu,
naftëtarë dhe punëtorë.
uzinën gjigante do të ngrenë,
do të rinohet vendlindja ime,
do të prodhojë najlon,
dhe gjalpë nga nafta do të nxjerrë...

Poetët
nga çdo anë do të vijnë,

do t'i këndoijnë
qytetit të ri industrial,
ritmet do të vërshojnë në poezi,
do të saldohen vargjet me metal.

E bukur
Mallakastra ime,
e mbështjellë si me ylbere
nga fontana dhe reflekse nafte,
do të hyjë në pesëvjeçarët e rinj,
në poemat e ardhshme...

1970

QYTETI ALPIN

Eci rrugëve të këtij qyteti
dhe ndjej diçka të re në shpirt,
më rreh fytyrën flladi malor
që fryn nga peizazhi epik.

Eci dhe Alpet më vështrojnë
si kreshnikë të eposeve,
në gjoks legjenda trimërie,
në kokë qeleshe dëborc...

Ej, roje shekullore,
unë e dua qytetin e alpeve,
e dua këtë qiell kaq blu,
rapsoditë, sondat, ujvarat!

E dua këtë qytet të ri,
të gjallë, shtatlartë,
rritur në gji të bjeshkëve
si trëndafil gjigant...

Trëndafil i bardhë
me petale guri,
rrënjet e tij janë duar malësorësh,
gjaku dhe emri i Bajram Currit.

DHURATË PRANVERE

Pranvera solli drithërime të reja,
më solli dhe një tufë me lule,
lule bjeshke të kaltëra, të verdha,
që i mblodhi sot një vogëlushe.

Kishte ardhur herët në mëngjes,
fshehtas në klasë qe futur,
tufën pati lënë mbi tryezë
dhe kishte ikur si flutur...

I vështroj fytyrat si gonxhe,
sytë e qeshur dhe plot dashuri...
Kush tufën e bukur ma solli,
nuk mundem ta gjej kurrsesi!

Si kjo tufë me lule pa emër,
një tufë ëndrra më solli pranvera,
shqetësime të mëdha la në zemër,
më la në buzë motive të reja.

7 mars 1973.

T O K A

Kraharorin si nënë ka hapur,
merr farën në gjirin e butë...
Sa bujare kjo tokë e dashur,
nuk lodhet së dhëni kurrë!

Nën shtresën e borës së ngrirë,
gjelbëron kalliri i ri,
toka e mëkon me durim,
nga trupi i jep ngrohtësi...

Grunoren me gërshteta të artë,
me gaz do ta korrim në verë,
toka gjirin bujar do të hapë,
që të rritë kallinj të tjerë...

MOTIV STUDENTESK

Ky qytet ka banorë të çuditshëm,
vetëm të rinj,
ky qytet jeton një stinë të vetme,
vetëm pranverë!

Më ngazëllen kjo pranverë,
ky qytet,
tani jam banorja e tij
më e qeshur...

Kur flas dhe shkruaj për të,
e quaj me ton intim
«Porti i ëndrrave të mëdha»,
qyteti im.

S'do të ketë kurrë thinja në kokë,
çdo vit përtërihet
si blerimi i fushave, i drurëve,
çdo prill.

Përherë gjelbëron ky qytet,
kur rrugëve ecim të gëzuar
me projekte digash, minierash,
me vargje në duar...

Me pëllëmbën e ngrohtë
më ledhaton dielli,
nxitoj nëpër agimet e shqetësuara
të këtij qyteti!

1968

KUR SHKOVA NË BAJRAM CURRI

Kapërcyem qafa malesh,
kantiere,
lumenj...
Qyteti alpin mes gështenjave,
i sigurt,
u ngrit para nesh.

Në rrugët e pjerrëta zbritëm;
malësorët
na pritën me fjalë të ngrohta:
«Mirë se ardhët, shoqe mësuese,
ne
do t'ju duam si çikat tonë!»

Më i dashur na u bë qyteti alpin
atë çast,

kur rrëth nesh,
të qeshurat e fëmijëve,
i rrahën flatrat
si pëllumbë të bardhë...

P A S A R D H È S I T

Nxënësve tē mi

Në sytē tanë
pasardhësit e denjë

rriten

tē shëndetshëm,
tē zgjuar,
shtatlartë.

Në èndrrat e tyre,
hapësira me diell,

krahët e bardhë
komunizmi
i zgjat!

Ata rriten shpejt
si shtati i kalirrit,
njohnin ligjet,
tē fshehtat
e planetit,

me predhën e parë
godasin objektivin,
të etur
thithin
mendimet e Enverit...

F I E R Z È · 1973

Kalojnë rrugës
njerëz me çizme,
me pluhur në kominoshe e flokë,
Drinin që rreh brigjet me gjëmimë,
do ta mposhtin me krahët e fortë.

Tejepërtej
tuneli shpon malin,
me syrin gjigant po na sheh,
ne futemi brenda,
shpejt dalim.
Përse ndodh kështu, përse?

Tronditit tokën
sondat e hekurta,
ne vështrojmë të mahnitur, me frikë,

sondisti i ri qesh me gjithë zemër,
mbi murin e lartë betonik...

Një dëshirë
shpërthen brenda meje,
me shiun, valët, gurët të përleshem
të drejtoj sonda, të hap tunele,
me vizitorë të drojtur të qeshem!

S I V J E T

Sivjet më e bukur pranvera,
dhe dielli më i ndritur sivjet,
në kraharorin tim plot ndjenja,
një tallaz i çuditshëm buçet.

Zogu dehet me ajrin e dlrë
dhe molla në kopsht lulëzoi,
në rrugët ku dëbora ka shkrirë,
siluetën e dashur kërkoj...

Dashuria me duart e gjelbëra
në zemër me vrull po troket...
Sivjet më e bukur pranvera,
dhe dielli më i ndritur sivjet.

1973

D H E M B J E

A. Xhumarit

Pallati 15 në zi.

Xha Andoni ka vdekur!..

Heshtin radiot,
sytë lagen me lotë,
arkivolin përcjellin shokët e miqtë,
përcjellin veteranin
në tokën e ftohtë.

Si u ndave kaq papritur nga ne,
xha Andon,
këtë ditë janari,
kur pranvera e tridhjetë
dritaret e gjelbëra të gëzimit ka hapur?

Ti e deshe shumë pranverën,
xha Andon.

Për të kapërceve llogore e lumenj,
që Shqipëria të ecte nëpër shtigjet e ëndrrave,
nëpër shtigjet e diellit.

I rishoh sytë e tu të thellë e fisnikë.
flokët me thinja të hapur mbi jastëkun e bardhë.
Kur në sytë e vogëlushëve
si rreze agimi në liqene alpinë,
hidhje imazhe heroizmash të luftës...

Pallati 15 në zi.
Ti s'je më, xha Andon,
dhe unë këto vargje
si kurorë lulesh mbi qetësinë tënde i vë.

Kujtimi yt të mbetet i gjelbër,
buzëqeshja jote mbi degët e ditët
të hapet si diell, si këngë...

ÇDO MËNGJES

Çdo mëngjes
qyteti zgjohet nga ritmet,
si llastarë shtohen pallatet e reja,
shtati i uzinës rritet.

Çdo mëngjes
gjithë gaz hidhet,
vogëlushi me përparëse të bardhë
me dorë babanë përshëndet
në katin e gjashtë.

Çdo mëngjes
në xama përthyhen,
tufat e bardha të rrezeve,
duket sikur qyteti u buzëqesh
punëtorëve majë skelave...

R I N J O H J E

Ej, komandante!.. Dëgjova një zë,
një vajzë e panjohur erdhi drejt meje,
në qafë m'u hedh, u përqafova me të
dhe m'u kujtua aksionistja Leze...

M'u kujtua sektori plot zëra të gëzuar,
traseja që zgjatej përmes grurit të ri,
Lezja që shihte e drojtur, e hutuar
dhe shaminë e bardhë e ulte mbi sy...

Ku është Lezja me gërshetin e gjatë,
që prishi fejesën e shqelmoi zakonin?
Ajo që fshehtas këndonte çdo natë,
tani, ndjek në Tiranë konservatorin...

1970

NËNËS SIME

Nënëz e dashur, mos rri kokulur,
e menduar, për mua mos rri!..
Pse të duket sikur paskam humbur
shumë larg, diku në veri?

Ta do zemra, moj nënëz e mirë,
çupën e vetme afër ta kesh,
por unë e zgjodha vetë rrugën time
ku duhet të ngjitem përjetë...

O nënëz, mos rri e brengosur,
nën ullinjtë që pikojnë yje mbrëmjeve,
të përshëndes nga veriu flokëdëborë,
nga qyteti alpin mes gështenjave!

P E I Z A Z H

Flokët e gjelbër të pishave
pasqyrohen, lahen në lumë,
Si drenushë Valbona hidhet,
më spërkat fytyrën me shkumë...

Valbonë, dua të rri me ty,
të eci në brigjet e tua,
kaltërsinë të ma lësh në sy,
freskinë të ma falësh në duar...

Si këngë grykave oshëtin,
Valbona që zbret valë-valë,
sot shpirtin ma mbush ngazëllim,
qielli blu dhe uji kristal!

KUR TË PRES

Kur të pres,
zemra ime drithërohet,
rreh fort.

I dashur, emri yt
gjoksin tim
ma çukit si zog.

Kur të pres,
hapat e tu në rrugë
trokasin fort,
i dashur, emri yt
në buzët e mia
cicërin si zog!

MBRËMBJE VEROIRE

Malet rreth nesh, statuja të bronxëta,
sikur na kërkojnë një premtim të madh,
na bien mbi supe zambakë dëbore,
kur lëvizim peizazhit të bardhë.

Në shpirt kemi këto vise të bukura,
ujvarat zhurmuese dhe kreshtat e ashpra.
ku në tela çiftelish, në lahuta,
rend Shota si pishat shtatlarta.

Era që fryn dhe dëborën e shkund
sikur i shpleks gërshetin mbi pisha,
Shota trime e veshur me zhgun
lirinë tonë nanuriti me krisma.

Pushkën mbuluar me borë të ngrirë
s'e lëshojnë pëllëmbët tona strall...
Le të shfryjë egër era në rrëpirë,
para saj jemi kreshtë, jemi mal.

Toka jonë nevojë po të ketë,
ne, vajzat zboriste me uniformë kaki,
si Shota trime me zhgun e gërshtetë
do të hyjmë në lahutë e çifteli...

TË SHTRENJIT ENVER

I shtrenjti Enver,
kudo je me ne
e ne kudo jemi me ty.

Ne sytë kemi te ti,
mendimet te ti
e zemrën me ty!

Gjeneratë pas gjenerate
Enveri me ne
e ne me Enverin!

1970

UNË DHE MOTIVET

Nuk e di se ç'ka ndodhur me mua,
përmbi letër lapsi hiqet zvarrë,
si burim i thatë vargjet shteruan
dhe fletorja më mbeti e bardhë.

Ku janë vallë të bukurat motive?
Ato s'flenë albumeve me gjethë të rëna;
lulëzojnë e rriten brazave, galerive
dhe poligoneve ku gjëmojnë të shtënat.

Po vij dhe unë, o motive të dashura,
drejt jush atje në arë e uzinë,
ritmet të shkunden mbi fletët e bardha
e vargjet parreshtur të më vijnë.

Të gatuhën vargjet me çelik e dritë,
mbi to të hidhen krisma e grurë,
që kënga ime të blerojë çdo ditë
dhe frymëzimi të mos shterrojë kurrë!

U Rrit vëllai

U rrit vëllai,
që rendte pas makinave,
që mbushte dhomat
me traktorë, aeroplanë
dhe imitonë
zhurmat e borive...

U rrit vëllai,
që me fëmijët e lagjes
ndizte lojë lufte
dhe me shkopin e lidhur me gjalm
«Para partizanë!»
thërriste rrugëve...

U rrit vëllai,
tani i menduar rri,

mbi librat plot ligje, formula.
Në sytë e tij plot ëndrra,
shoh konstruktet e nesërme
të uzinave
dhe urave...

U rrit vëllai!

KËNDON FATIME SOKOLI

Sa bukur i rri rapsodes sykaltër
çiftelia e lashtë, burrërore,
fluturon si dallëndyshe në ajër,
kënga e saj e dëlirë, melodioze!..

Sjellin krisma mbi tela të rënët,
mbrëmjet alpine plot drita buzëqeshin,
Enveri me malësorë rrok pëllëmbët
sikur malet përqafojnë njëri-tjetrin.

Zëri i ëmbël i Fatime Sokolit
gurgullon si burimet e bjeshkëve,
telat e çiftelisë nën gishtat e hollë
mbushen lule si degët e pjeshkëve...

NATË AKSIONI

U thye errësira e natës,
doli hëna.

Flokët e saj bjondë
mbi grunjëra i kreh.

Rrezet hyjnë në fjetore,
më përkëdhelin me duar.

Krevati im po lëkundet
si kolovajzë ëndrrash...

Shina, stacione shoh,
shami që luhaten në erë.

Mes fushave rend treni
si vargan dasmorësh.

Treni trokon me gëzim,
mbi binarët e ditëve tonas...

Mbi krevatin tim
pikon qumësht hënëc.

1967

N I S J E

E nisa këngën time të parë
në pranverë...
Është stina e dashurive,
e luleve, e zogjve,
e ëndërrave me diell,
stina ime.

Ndjej si shpërthejnë rrëth meje
alarme dhe këngë,
buçitjet e minave,
gurgullima dhe zëra pranverorë
oshëtijnë
në buzët e tokës sime.

Sot
këngën time të qeshur

nisa midis tyre,
në stinën e luleve, zogjve,
të dashurive, ëndrrave,
në stinën time,
PRANVERË KOMUNISTE!

PASQYRA E LËNDËS

	Faqe
Nesër	3
Fjalët e mia	4
Përplasen epokat	6
Portret	7
Montatorët	8
Çast	9
Mendoj	10
S't'u lodhën këmbët, baþa	11
Pranverë në ekran	13
Neveri	15
Pishtari	17
Sonte	19
Pensionistët në Fierzë	20
Migjeni dha drita	22
Ushtarake	24
Ëndrrat dhe fishekzaret	25
Vendlindjes	26
Qyteti alpin	28
Dhuratë pranvere	30
Toka	32
Motiv studentesk	33
Kur shkova në Bajram Curri	35
Pasardhësit	37
Fierzë 1973	39
Sivjet	41
Dhembeje	42

Faqe

Çdo mëngjes	44
Rinjohje	45
Nënës sime	46
Peizazh	47
Kur të pres	48
Mbrëmje veriore	49
Të shtrenjtit Enver	51
Unë dhe motivet	52
U rrit vëllai	54
Këndon Fatime Sokoli	56
Natë aksioni	57
Nisje	59

Redaktor: Pandeli Koçi
Piktor: Roland Karanxha

Tirazhi 1.000 kopje Format 70x100/32 Stash: 2204-72

Shtyp. Drejtoria Qendrore Poligrafike
Shtypshkronja «8 NËNTORI» — Tiranë, 1974